



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE GJILAN**

Numri i lëndës: 2023:158707

Datë: 14.05.2024

Numri i dokumentit: 05683642

**CPK.nr.62/2023**

**P. nr. 290/23**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil,** gjyqtari Gazmend Ajvazi, me bashkëpunëtorin profesional Baki Sylejmani, duke vendosur në procedurën përbarimore të kreditorit: KRU “.....” sh.a, të cilën e përfaqëson Kryeshefi Ekzekutiv Y.... S... nga Gj...., ndaj debitorit M...R... nga Gj..., Rruga “...”, nr.7, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të datës 06.07.2023, jashtë seancës më datë 13.05.2024 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. REFUZOHET** si i pa bazuar prapësimi i datës 06.07.2023 i debitorit M...R... nga Gj..., i paraqitur kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.290/23, të datës 30.06.2023, i lejuar nga Përbaruesi Privat Kushtrim M.Musa nga Gjilani dhe urdhri i lartcekur **mbetet në fuqi**.

**II.** Obligohet debitori Mustafë Rexhepi, që në afat prej 15 ditëve, emër të taksës për ushtrim të prapësimit të paguajë shumën prej 40€ konform Udhëzimit Administrativ nr.1/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.

**III.** Në rast të paraqitjes të ankesës kundër këtij aktvendimi **OBLIGOHET** debitori Mustafa Rexhepi nga Gjilani, që të deponojë shumën e të hollave në lartësi për 300€, në emër të garancisë. Nëse pala ankuese dështon ta paguajë shumën e garancisë të caktuar nga gjykata, ankesa konsiderohet se nuk është dorëzuar fare në gjykatë.

**A r s y e t i m i**

Përbaruesi Privat Kushtrim M.Musa nga Gjilani ka lëshuar Urdhrit Përbarimor të propozuar nga kreditori, kundër debitorit, lidhur me përbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht faturës së datës 31.05.2023 si dhe marrëveshjes për programim të borxhit të datës 25.11.2022 në shumë prej 3,104.23 euro si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës së Përbaruesit Privat në shumë prej 47.20 euro.

Debitori, pas pranimit të urdhrin përbarimor, në afat ligjor, më datë 06.07.2023 ka ushtruar prapësim, duke e kundërshtuar në tërësi urdhrin përbarimor të përbaruesit privat duke e respektuar marrëveshjen pagesën e obligimit në tërësi, meqenëse për shkak të disa vështirësive

dhe vonesave të pagesave janë bërë disa veprime dhe pagesat do të bëhen sipas marrëveshjes. Po ashtu ka shtuar se të paqëndrueshme janë provat dhe faktet në të cilat thirret kreditori. Në fund i ka propozuar gjykatës që këtë përmbarim ta shfuqizojë dhe debitorin ta liroj nga detyrimet përmbarimore.

Kreditore, në përgjigjen në prapësim të datës 17.07.2024 i ka kundërshtuar pretendimet e debitorit të theksuara në prapësim, si të pabazuar, pasi që debitori me vullnetin e tij të lirë sipas bindjes së tij ka lidhur marrëveshjen nr.6860 të datës 25.11.2022 për ri programimin e borxhit me kreditorin në shumë prej 3,107.90 € dhe është zotuar se borxhin e lartcekur do ta paguaj me këste mujore në një kohëzgjatje prej 48 kësteve mujore ku vlera e këstit mujor është prej 64.75 euro plus faturën e rregullt të harxhimit të ujit të njëjtën e ka nënshkruar dhe pranuar si të tillë por me kalimin e kohës i njëjti nuk e ka përmbyshur me kohë detyrimin dhe nuk iu ka përmbytur marrëveshjes për pagesën e kësteve mujore e as pagesës së faturave të rregullta për harxhimin e ujit gjë që mund të argumentohet në bazë të kartelës për konsumatorë të dt.21.06.2023 ku shifet se pas riprogarmimit të borxhit nuk janë kryer pagës të këstit mujor e as pagesa të faturës së rregullt të harxhimit të ujit. Në fund i ka propozuar gjykatës që pas shtjellimit të gjitha provave relevante dhe arsyeve të paraqitura prapësimin e debitorit M...R... nga Gj...,ta refuzojë si të pabazuar.

Gjykata, pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, pretendimeve të palëve, vërtetoi se prapësimi i debitorit është i pabazuar, pasi që me këtë prapësim nuk ka vërtetuar asnjërin nga shkaqet të cilat janë paraparë në nenin 71 të LPP-së lidhur me bazueshmërinë e prapësimin dhe se fatura e bashkëngjitur në propozim për përmbarim, si dhe Marrëveshja për programim të borxhit nr.6860 e datës 25.11.2022 paraqesin titull përmbarimor – dokument të besueshëm, duke u bazuar në nenin 29 par.1 nën par.1.3 të LPP-së.

Pretendimi i debitorit se i njëjti ka pasur disa vështirësi dhe vonesa të pagesave për gjykatës është i pabazuar ngase i njëjti me vullnet të lirë dhe pa kurrfarë presioni ka nënshkruar Marrëveshjen për Programimin e borxhit në shumën e lartcekur.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, bazuar në nenin 78 pika 1 dhe 2, që debitori të paguajë shumën prej 300 €, nëse eventualisht paraqet ankesë. Sa i përket shumës së caktuar, gjykata është e mendimit se shuma e caktuar është në interesin e të dy palëve, edhe për kundër se pika 2 e dispozitës së lartcekur, ka paraparë të caktohet shuma e plotë e kredisë, por për shkak të gjendjes së përgjithshme ekonomike, caktoi 10% të shumës së plotë të kredisë.

Nga të cekurat më lartë e në pajtim me nenin 5, 29, 71, 73 dhe 78 të LPP-së, u vendos si në pikën I dhe II të këtij aktvendimi.

**Gjyqtari,**  
**Gazmend Ajvazi**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, brenda 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, përmes kësaj gjykate.